



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 832 / prot.
9

Vlorë, më 14.05.2021

VENDIM

Nr. 22, datë 12. 05. 2021

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT 2 VJEÇAR NË AKUAKULTURË
DHE HIGJENË E PRODUKTEVE TË PESHKIMIT, APLIKUAR PËR VITIN
AKADEMIK 2021- 2022**


Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, shkronja dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemalli", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës, 12. 05. 2021

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e **Programit 2 vjeçar në akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit**, aplikuar për vitin akademik 2021- 2022, (sipas rregullores bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Adresa /Adress: Sheshi Pavarësia, Skelë – Vlorë
Web-site: www.univlora.edu.al

**RREGULLORJA E PROGRAMIT MËSIMOR TË STUDIMEVE
JOUNIVERSITARE:**

**DIPLOMË PROFESIONALE
“AKUAKULTURË DHE HIGJENË E PRODUKTEVE TË
PESHKIMIT”**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Statutin e Rregullores së Universitetit 'Ismael Qemali' të Vlorës.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

Departamenti i Biologjisë është një nga Departamentet më të rinj të Universitetit "Ismael Qemali", i hapur në kuadrin e Fakultetit të Shkencave Teknike në vitin akademik 2010 -2011, me vendim të Këshillit të Ministrave **Nr. 124 datë 17.02.2010**. Departamenti i Biologjisë synon të ofrojë një formim të shkëlqyer akademik për të përgatitur profesionistët e ardhshëm të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar të vendit. Programi mësimor Diplomë Profesionale "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" është program i studimeve Jouniversitare, i ofruar nga Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Teknike në Universitetin 'Ismael Qemali' Vlorë dhe është i organizuar në dy vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë 120 ECTS dhe marrin Diplomën Profesionale: "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit".


Neni 2

Objektivat formuese të programit të studimit Diplomë Profesionale, "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit".

Përmes bashkëpunimit me njësi të tjera të Universitetit tonë, organizata të ndryshme, Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, ne synojmë të përgatisim Teknologë të Akuakulturës, të aftë të zbatojnë dhe menaxhojnë proceset e prodhimit të produkteve të peshkimit në një varg mjedisesh ujore dhe të kuptojnë sistemet që rregullojnë disponueshmërinë, sigurinë dhe standartet e cilësisë së prodhimeve të peshkimit dhe kontrollet për rrezikun shëndetësor të konsumatorit. Programi profesional "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" synon të krijojë specialistë të afirmuar në sektorin e njohjes së procedurave të kontrollit të produkteve të peshkimit.

Objektivat formuese të programit profesional "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit":

- Të pajisë studentë me njohuritë bazë të formimit shkencor, duke i fokusuar vecanërisht në fushën e akuakulturës dhe higjenës së produkteve të peshkimit.
- Të krijojë mundësinë e përvetësimit të njohurive aftësive dhe kompetencave tek studentët duke i afirmuar si profesionistë dhe menaxhues të akuakulturës.
- Të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e akuakulturës nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve njerëzore profesionale të përshtatshme.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Ky program profesional do të përgatisë specialistë të aftë për të punuar në institucione shtetërore apo private si (Agjensia Kombëtare e Ushqimit AKU si vlerësues i cilësisë së produkteve të peshkimit në terren, fabrika konservimi etj, Impiantet e akuakulturës që përfshijnë ujërat e ëmbla (troftikulturë, ujëmbledhës) dhe ato detare (kultivimi me kosha, kultivimi i midhjes), Teknikë të inspeksioneve të akuakulturës dhe peshkimit pranë agjensive të ministrive (vlerësues i llojeve në zhdukje, sasia e peshkimit, llojet, madhësia e lejuar, dimensionet e rrjetave etj), Asistent laborant për vlerësimin e cilësisë së produkteve të peshkimit në laboratore të agjensive mjedisore, Teknikë të kontrollit në fabrikat e konservimit të produkteve të peshkimit, Kontrollor teknikë pranë strukturave doganore të import-eksport, Anëtarë të organizatave të menaxhimit të peshkimit (OMP) rajonale e lokale dhe në OJF-të me fokus zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit etj).

Ne ofrojmë për studentët tanë:

- ☞ Cilësi në mësimdhënie duke aplikuar forma bashkëkohore të mësimdhënies.
- ☞ Përgatitje të lartë profesionale
- ☞ Zhvillimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.
- ☞ Pjesëmarrje dhe përfaqësim dinjitoz në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ☞ Një staf plotësisht të kualifikuar i cili prezantohet me:
 - Artikuj Shkencorë të botuar
 - Libra të botuar
 - Konferenca kombëtare e ndërkombëtare

Prioritet i departamentit tonë gjatë programit të studimit Diplomë Profesionale, "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit", është jo vetëm pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore e profesionale në fushën e shkencave ushqimore (edhe biologjike), për të kryer përcaktime të shpejta, të sakta dhe me një shkallë të lartë sigurie sipas kërkesave, por edhe hedhja e themeleve për të përgatitur specialistë në fushën e Teknologjisë së Akuakulturës në industri, institucione mjedisore, laboratorë universitarë etj, duke e lejuar studentin e diplomuar të futet në aktivitete pune që kërkojnë familjaritet me metodën shkencore, aftësi përdorimi të metodologjive të ndryshme dhe mjeteve të ndryshme laboratorike.

Institucioni u siguron studentëve një formim bazë cilësor për të siguruar bazat e të ardhmes së tyre nëpërmjet:

- ☞ Kontributi në mënyrë efektive në formulimin dhe zbërthimin e politikave arsimore dhe vizionin e Universitetit të Vlorës, miratimin e rregulloreve të Universitetit dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë, duke reflektuar praktikën më të suksesshme kombëtare e ndërkombëtare.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

- ☉ Kontributi në formulimin dhe miratimin e politikave dhe rregullave përkatëse për rritjen e rolit të institucioneve akademike, duke përfshirë këtu përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në fushat që departamenti mbulon.
- ☉ Përpunimi i planeve mësimore (kurrikulat) sipas kërkesave të Deklaratës së Bolonjës dhe orientimi i programeve mësimore drejtë Institucioneve homologë perëndimorë.
- ☉ Kualifikimi i stafit akademik nëpërmjet specializimeve pasuniversitare dhe marrjes së titujve dhe gradave shkencore.
- ☉ Përmirësimi i materialeve didaktike në shërbim të mësimdhënies.
- ☉ Zhvillimi i laboratoreve mësimorë në nivelet bashkëkohore të mësimdhënies.
- ☉ Lidhja me organizata dhe institucione të tjera që kanë qëllime të përafërta apo që ndihmojnë rehabilitimin e politikave rajonale arsimore, mjedisore, etj.
- ☉ Zgjerimi i informacionit mbi departamentin dhe marketimi i tij në zona të tjera të Shqipërisë.
- ☉ Forcimi i procedurave të pranimit të kandidatëve të rinj në stafin akademik të mësimdhënies, përmes kritereve të qarta të testimit.
- ☉ Përfshirja e mendimit të studentëve për arritjen e objektivave të mësipërm.
- ☉ Evidentimi i drejtimeve të reja të ekonomisë së tregut për Rajonin e Vlorës dhe më gjerë, zhvillimin e arsimit, problemet e mëdha mjedisore dhe menaxhimi i tyre.
- ☉ Bazuar në nevojat në tregun e punës, përgatitja e teknikëve të laboratorit të ardhshëm, të aftë për tregun e punës: në industri, agjensi mjedisore, laboratorë shkencorë etj.

Neni 3.

Ngarkesa mësimore në orë sipas formave të mësimdhënies

Ndarja e orëve mësimore për hartimin e programit të Diplomës Profesionale në **"Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit"**, është bërë duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Neni 4

Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.

Tabela 1- Ndarja e disiplinave sipas tipit të veprimtarive formuese				
Lëndë të detyrueshme				
Disiplinat	Nr.	Kodi	Lënda	Kredite
Disiplina të formimit të përgjithshëm (8 kredite)	1.	BIO 170	Hidrobiologji	8
			Biologji detare	4
			Biologji e ujërave të brendshëm	4
Disiplina të formimit karakterizues (64 kredite)	2.	BIO 192	Implantet e akuakulturës	8
			Teknika e ndërtimit të impianteve	4
			Implantet e kultivimit të gjallesave	4
	3.	BIO 275	Higjienë dhe teknologji e produkteve të peshkimit	8
			Higjienë e produkteve të peshkimit	4
			Teknologjia dhe perpunimi i produkteve të peshkimit	4
	4.	BIO 277	Fiziologjia e riprodhimit të organizmave ujorë	6
	5.	BIO 174	Mikrobiologji dhe patologji e organizmave ujorë	8
			Mikrobiologji dhe imunologji e organizmave ujorë	4
			Parazitologji dhe patologji e organizmave ujorë	4
	6.	BIO 294	Ushqimi i kafshëve ujorë dhe teknikat e të ushqyerit	6
	7.	BIO 196	Akuakulturë	8
			Bazat e akuakulturës	4
			Akuakulturë e gjallesave shtazore	4
Disiplina e lëndëve integruese / ndërdisiplinore (22 kredite)	8.	BIO 297	Praktikë profesionale 1	10
	9.	BIO 298	Praktikë profesionale 2	10
	10.	BIO 291	Ekotoksikologji	6
	11.	BIO 171	Biologji e përgjithshme dhe Biokimi	8
			Biologji e përgjithshme	4
			Biokimi	4
Disiplina të formimit plotësues (12 kredite)	12.	BIO 172	Zoologjia e gjallesave ujorë	8
			Invertebrorët ujorë	4
			Vertebrorët ujorë	4
Disiplina të formimit plotësues (12 kredite)	13.	ENGT 131 / ITAT 131	Gjuhë Angleze / Italisht 1	6
	14.	CST 130	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	6
Detyrime përmblledhëse (14 kredite)	15.	BIO 299	Provim diploma	14





UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISE



Neni 5

Plani mësimor i programit Diplomë Profesionale, "Akultururë dhe higjën e produkteve të peshkimit" për të dy vitet e studimit

Tabela 3- Plani mësimor i Diplomës Profesionale, "Akultururë dhe higjën e produkteve të peshkimit" për të dy vitet e studimit

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredite	Tot. orë / semestër Brenda & jashtëauditorit	Tot. orë / semestër në auditor	Totali orë / javë në auditor					Projekte kursi/ Dejtrë kursi	Totali orë jashtëauditorit Dejtra
							Leks	Sem	Lab/Pr-Ditë				
Viti i parë	Sem I 14 Javë + 1 Javë praktikë	1. BIO 172	Zoologjia e gjallesave ujorë	8	200	98	3	2	2/5			1/1	102
			Invertebrorët ujorë	4	100	49	1.5	1	1/3			1/0	51
			Vertebrorët ujorë	4	100	49	1.5	1	1/3			0/1	51
		2. BIO 170	Hidrobiologji	8	200	70	3	2	0/0			1/1	130
			Biologji detare	4	100	35	1.5	1	0/0			1/0	65
			Biologji e ujërave të brendshme	4	100	35	1.5	1	0/0			0/1	65
		3. BIO 171	Biologji e përgjithshme dhe Biokimi	8	200	70	3	2	0/0			0/0	130
			Biologji e përgjithshme	4	100	35	1.5	1	0/0			0/0	65
			Biokimi	4	100	35	1.5	1	0/0			0/0	65
		4. CST 130	Teknologji informacioni dhe Komunikimi	6	150	70	2	2	1/0			2/1	80
		TOTAL		30	750	308	11	8	3/5 Ditë Pr			4/3	442
	Sem II 14 Javë + 1 Javë praktikë	5. BIO 196	Akultururë	8	200	65	3	2	0/5			1/1	135
			Bazat e akultururës	4	100	32.5	1.5	1	0/2			1/0	67.5
			Akultururë e gjallesave shtazore	4	100	32.5	1.5	1	0/3			1/1	67.5
		6. BIO 174	Mikrobiologji dhe patologji e organizmave ujorë	8	195	72	3	2	1/0			1/1	123
			Mikrobiologji dhe imunologji e organizmave ujorë	4	97.5	39.5	1.5	1	1/0			1/0	58
			Parazitologji dhe patologji e organizmave ujorë	4	97.5	32.5	1.5	1	0/0			0/1	65
		7. BIO 192	Implantet e akultururës	8	200	65	3	2	0/5			2/0	135
			Teknika e ndërtimit të implantëve	4	100	32.5	1.5	1	0/2			1/0	67.5
			Implantet e kultivimit të gjallesave	4	100	32.5	1.5	1	0/3			1/0	67.5
		8. ENGT 131/ ITAT 131	Gjuhë Angleze / Italisht I	6	145	52	3	1	0/0			0/0	93
Viti i dytë	Sem I 11 Javë + 4 Javë Praktikë	TOTAL		30	740	254	12	7	1/10 Ditë Pr			4/2	486
		9. BIO 291	Ekotoksikologji	6	150	44	2	2	0/0			0/1	106
		10. BIO 297	Praktikë profesionale 1	10	250	0	0	0	0/4 Javë Praktikë			0/0	250
		11. BIO 277	Fiziologjia e riprodhimit të organizmave ujorë	6	150	44	2	2	0/0			0/1	106
		12. BIO 275	Higjënë dhe teknologji e produkteve të peshkimit	8	200	66	3	2	1/0			2/0	134
			Higjënë e produkteve të peshkimit	4	100	38.5	1.5	1	1/0			1/0	61.5
			Teknologjia dhe përpunimi i produkteve të peshkimit	4	100	27.5	1.5	1	0/0			1/0	72.5
		TOTAL		30	800	154	7	6	1/4 Javë Pr			2/2	596
	Sem II 11 Javë + 1 Javë Pr	13. BIO 298	Praktikë profesionale 2	10	250	0	0	0	0/4 Javë Pr			0/0	250
		14. BIO 294	Ushqimi i kafshëve ujorë dhe teknikat e të ushqyerit	6	150	44	2	2	0/0			0/1	106
		15. BIO 299	Provimi diplome	14	350	0	0	0	0/0			0/0	350



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISE



	TOTAL	30	750	44	2	2	0/4 Javë Pr	0/1	706
	TOTAL I TË DY VITEVE	120	3040	760	32	23	5/11 Javë Pr	10/8	2230





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Neni 6

Katalogu i moduleve të programit Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit"

BIO 172 Biologjia e gjallesave ujorë

Invertebrorët ujorë (Modul 1)

Zoologjia invertebrore ka si objekt studimi kafshët parruazore. Ajo synon t'u japë studentëve njohuri bazë mbi larminë e botës së gjallë të kafshëve invertebrore duke filluar që nga njëqelizorët e thjeshtë e deri tek kafshët më të evoluara shumëqelizore.

Vertebrorët ujorë (Modul 2)

Zoologjia vertebrore ka si objekt studimi kafshët rruazore (Vertebrorët). Ajo synon t'u japë studentëve njohuri bazë mbi origjinën, evolucionin, sistematikën e grupeve kryesore të vertebrorëve (nga peshqit deri tek gjitarët) si dhe çdo element tjetër strukturor e funksional i domosdoshëm për shpjegimin e evolucionit të këtyre kafshëve.

BIO 170 Hidrobiologji

Biologji detare (Modul 1)

Në modulën e Biologjisë detare, studentët do të marrin njohuri bazë mbi organizimin dhe klasifikimin e ekosistemeve detare, karakteristikat abiotike të mjedisit detar si dhe marrëdhëniet e njeriut me mjedisin detar.

Biologji e ujërave të brendshëm (Modul 2)

Në modulën e Biologjisë së ujërave të brendshëm, studentët do të marrin njohuri bazë mbi organizimin dhe klasifikimin e ekosistemeve të ujërave të ëmbla; karakteristikat abiotike të mjedisëve me ujëra të njelmëta dhe të tejkrupur, karakteristikat abiotike të ujërave liqenore; funksionimin e ekosistemit liqenor si dhe ndikimin e njeriut mbi ekosistemin liqenor.

BIO 171 Biologji e përgjithshme dhe Biokimi

Biologji e përgjithshme (Modul 1)

Moduli "Biologji e përgjithshme", ka si objektiv të pajisë studentin me disa nga konceptet bazë biologjike si ato të teorisë qelizore anatomisë, fiziologjisë dhe biokimisë. Përbërja dhe struktura e ADN-së. Acidi ribonukleik-ARN. Lipidet Viruset. Qëllimi i lëndës gjithashtu është fokusuar në pajisjen e studentëve me disa koncepte të anatomisë, të modeleve dhe mekanizmave biokimike të cilat bëjnë të mundur realizimin e proceseve fiziologjike qelizore si fotosinteza, frymëmarja, cikli qelizor, riprodhimi dhe zhvillimi si dhe tejçimi i tipareve nëpërmjet gjenetikës.

Biokimi (Modul 2)

Studentët në modulën e Biokimisë do të marrin njohuri bazë mbi veçoritë kryesore të komponentëve kimikë të qelizave, mënyrës së klasifikimit të tyre dhe karakteristikat për çdo klasë, si karbohidratet, lipidet, acidet nukleike etj. Do të mesojnë rrugët metabolike kryesore sipas llojeve të qelizave dhe rrugët metabolike të shpërbërjes së substancave të ndryshme, si glikoliza, fermentimi, frymëmarja, B-oksidimi, fotosinteza si dhe do të njihen edhe me llojet e analizave biokimike.

CST 130 Teknologji Informacioni dhe Komunikimi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Temat e trajtuara në lëndën Teknologji Informacioni dhe Komunikimi siguron një formim të përgjithshëm për bazat e informatikës. Në temat e trajtuara theksohet rëndësia e kompjuterit dhe informatikës në aspektin ekonomik. Studimi i pjeseve kompjuterike, i programeve bazë të paketës Microsoft Office, sistemet numerike, interneti dhe hyrje në algoritmike dhe programim në gjuhën C, shërben për të njohur në vija të përgjithshme bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

BIO 196 Akuakulturë

Bazat e akuakulturës (Modul 1)

Kjo disiplinë ka për qëllim njohjen e principeve të Akuakulturës si teknikë bazë e rritjes artificiale të gjallesave ujore në funksion të ekonomisë.

Akuakulturë e gjallesave shtazore (Modul 2)

Nëpërmjet studimit të modulit "Akuakulturë e gjallesave shtazore" do të njihen degët e prodhimit, mundësitë e zhvillimit të saj në vendin tonë, disponibiliteti i sipërfaqeve ujore të përshtatshme si dhe qendrat për riprodhimin artificial. Kështu do të merren njohuri mbi proceset e teknikat e akuakulturës së midhjeve, vongolave, ngjalës, troftës, familjes së krapit, kocës si dhe levrekut. Për secilin lloj gjallesë të trajtuar studentet do të përforcojnë njohuritë edhe nëpërmjet praktikës në terren ku do të marrin informacion mbi sistemet e impianteve, kushte ekologjike të tyre, vecoritë morfo-anatomike, të ushqyerit, fazat e riprodhimit dhe të trajtimit të rasatëve.

BIO 174 Mikrobiologji dhe patologji e organizmave ujorë

Mikrobiologji dhe imunologji e organizmave ujorë (Modul 1)

Studenti në Modulin "Mikrobiologji dhe Immunologji e organizmave ujorë" do të marrë parimet bazë të bakteriologjisë, virologjisë dhe imunologjisë në mënyrë që të jetë në gjendje pastaj të merret me studimin e mekanizmave kryesore që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet agentit etiologjik dhe strehuesit të kafshëve; gjithashtu duhet të fitojnë njohuri për metodat kryesore të diagnostikimit të sëmundjeve infektive dhe imunizimit.

Parazitologji dhe patologji e organizmave ujorë (Modul 2)

Qëllimet e Modulit "Parazitologjia e produkteve të peshkimit": në fund të kursit studenti fiton njohuri për sëmundjet parazitare kryesore të peshkut, molusqeve dhe krustaceve, me referencë të veçantë ndaj etiopatogenezës dhe masave të profilaksisë dhe kontrollit. Studenti gjithashtu fiton aftësi praktike në diagnostikimin e parazitëve kryesore të kafshëve ujore.

BIO 192 Impiantet e akuakulturës

Në këtë disiplinë synohet të jepet informacion mbi parimet e ndërtimit e të funksionimit të impianteve të akuakulturës si sisteme riprodhuese me riqarkullim ujor si dhe praktikën e aplikimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

të tyre. Ajo është organizuar në dy module: "Teknika e ndërtimit të impianteve" Modul 1 dhe "Impiantet e kultivimit të gjallesave" Modul 2. Do të jepet informacion mbi elementet strukturore të ndërtimit të një impianti akuakulture, rregullimin e parametrave mjedisore në të si biofiltra, sisteme qarkullues, vaska ujore, rolin e elementëve kimike si dhe ruajtja e tyre në kushte standarte. Studentët do të fitojnë aftësi mbi vecoritë specifike të një sërë tipesh të impianteve si ai i rritjes së ngjallës, troftës, krapit, kocës, levrekut, midhjes, si dhe butakë të tjerë. Impiantet do të jepen të përshkruara në aspektin strukturor, funksional si dhe përparësitë që ofrojnë në raport me output-et tipet e ndryshme të tyre.

FNGT 131 Gjuhë Angleze

Bazuar në praktikuesit e industrisë dhe aplikimit kompjutacional, është kombinuar një program mësimor i fortë, me cikle të larta dhe me fjalor specifik. Sipas referencave të kurseve dhe informacionit të librit, qëllimi ynë është a) T'u paraqisim studentëve subjektin, strukturën e duhur, materialet që do të përdoren, dhe mënyrën e vlerësimit; b) Të vlerësohet saktësia e nxënësve në përdorimin e gjuhës angleze dhe në zhvillimin e aftësive komunikuese; c) Të krijohet mjedisi i duhur dhe atmosfera për zhvillimin e mësimin normal; d) Realisht studentët të vlerësohen në bazë të programit të vlerësimit me kriteret e specifikuar në këtë kurs.

ITAT 131 Italisht

Programi përmban një cikël temash të zgjedhura që e ftojnë studentin të reflektojë dhe të zgjedhë në mënyrë alternative nëpërmjet: sugjerimeve, fakteve apo teksteve interesante për diskutim. Temat e trajtuara në këtë lëndë synojnë: të aftësojë studentin të përdorë gjuhën italiane si mjet për të zgjeruar aftësitë kuptimore dhe shprehëse, të krijojë diskutim nëpërputhje me programin, nivelin, interesat dhe përvojat personale dhe të perfeksionojë të kuptuarit e njohurive lidhur me procesin, metodën gjuhësore dhe tematikën e vendosur si edhe të kompozojë e përshtasë informacione të ndryshme të marra prej mediave apo temave të parashtruara nga lektori.

BIO 291 Ekotoksikologji

Në fund të kursit studenti fiton njohuri mbi ndotësit kryesorë në mjedisin ujor, mbi dinamikën dhe kinetikën e tyre dhe mbi efektet e sistemeve të ndryshme, me theks të veçantë në imunitetin dhe endokrinën. Studenti është në gjendje të njohë helmimet kryesore dhe të aplikojë njohjen dhe metodat analitike për të konfirmuar hipotezën diagnostikuese. Ai gjithashtu është i aftë të kryejë një analizë të rrezikut toksikologjik të përcaktuar nga ndotësit më së shpeshti e gjetur në mjedis.

BIO 277 Ekofiziologji e organizmave ujorë

Qëllimi: kursi trajton disa nga aspektet kryesore fiziologjike të kafshëve detare të trajtuara nga një perspektivë krahasuese dhe mjedisore. Theksi është në ndërveprimin e kafshës me mjedisin (si kimiko-fizik ashtu edhe biotik). Qëllimi kryesor i ekofiziologjisë do të jetë trajtimi i mekanizmave fiziologjikë kryesorë të organizmave ujorë dhe përshtatshmëritë ekofiziologjike që ato paraqesin. Lënda do të fokusohet mbi mekanizmat ekofiziologjikë të llojeve në kushte ekstreme ekologjike si: mekanizmat osmotikë, presioni hidrostatik, temperaturat e larta etj.

BIO 275 Higjienë dhe teknologji e produkteve të peshkimit

Higjienë e produkteve të peshkimit (Modul 1)

Studentët në modulën "Higjienë e produkteve të peshkimit" do të marrin njohuri bazë mbi: normativën europiane për higjienën e produkteve të peshkimit, vlerësimin e cilësisë higjieno-sanitare të produkteve të peshkimit, vlerësimin e burimeve të kontaminimit si dhe metodologjitë e përshtatshme për konfirmimin e kriterëve të sigurisë ushqimore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Teknologjia dhe përpunimi i produkteve të peshkimit (Modul 2)

Studentët në modulin "Teknologjia dhe përpunimi i produkteve të peshkimit" do të marrin njohuri bazë mbi: normativën europiane për teknologjinë e produkteve të peshkimit, teknikat e përshtatshme për përpunimin dhe kontrollin e produkteve të peshkimit, standartet ndërkombëtare në sektorin ushqimor të produkteve të peshkimit si dhe vlerësimin e gjendjes së produkteve të peshkimit.

BIO 294 Ushqimi i kafshëve ujorë dhe teknikat e të ushqyerit

Ushqimi i kafshëve ujorë dhe teknikat e të ushqyerit synon të japë një formim të përgjithshëm mbi dietat ushqimore të llojeve të ndryshme të peshqve në akuakulturë. Në fund të kursit studenti fiton njohuri në lidhje me formulimin e dietave për speciet e të peshkut me interes në nivel kombëtar, metodat e administrimit dhe parametrat më të rëndësishëm për të përcaktuar shëndetin e kafshëve. Në fund të kursit studenti fiton aftësi të thella në lidhje me ushqimin e peshkut. Në veçanti, studenti i njeh nevojat ushqyese të peshkut dhe ushqimin që mund të përdoret në dietën e tyre. Gjithashtu njeh metodat e dozimit në varësi të moshës, peshës dhe kushteve biotike dhe abiotike si dhe ndryshimin e sasisë së komponentëve specifikë të ushqimit në varësi të cilësisë së peshkut që duhet të prodhohet.

BIO 297 Praktikë profesionale 1

Nëpërmjet Praktikës profesionale, studenti do të zhvillojë aftësi praktike në lidhje me tematikat e ndryshme të Identifikimit dhe Morfologjisë së organizmave kultivues të trajtuara në një periudhë 4 javore. Në fund të Praktikës profesionale, studentët do të jenë të aftë të njohin subjektet e ndryshme të Akuakulturës që ushrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri dhe në Vlorë, të njohin mjetet dhe pajisjet e nevojshme që përdoren në Akuakulturë si dhe të njohin llojet e ndryshme të peshqve e butakëve dhe fazat e zhvillimit të tyre.

BIO 298 Praktikë profesionale 2

Praktikat profesionale 2, do t'i mundësojë studentëve, nxënie të njohurive më të mira në lidhje me industrinë e akuakulturës dhe aktivitetet e saj specifike, nga ato themelore e deri ato të prodhimit final. Praktika profesionale 2 do të realizohet në një periudhë 4 javore, gjatë dy viteve të studimit në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" sipas specifikave që orientohet kandidati; në aktivitete të prodhimit të moluskëve, peshqve kockorë dhe në aktivitete të mbledhjes dhe kontrollit të prodhimeve të peshkut, gjithnjë të mbikëqyrur nga ekspertë të akuakulturës dhe nga stafi akademik i Departamentit të Biologjisë. Praktika mësimore do të realizohet me rotacionin e studentëve në aktivitetet e prodhimit dhe përpunimit të ushqimit, me qëllim familjarizimin e studentit me të gjitha procedurat e kontrollit të ushqimit.

BIO 299 Provim diplome

Për të përmbyllur studimet në diplomën profesionale "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" me 120 ECTS, studentët duhet të japin provimin e diplomës ku do të nënshtrohen një testimi me shkrim ose me gojë dhe do të vlerësohen nga anëtarët e komisionit AD-HOC të diplomimit të ngritur pranë departamentit të Biologjisë.

Neni 7

Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Teknike-UV duke nisur nga viti akademik 2011- 2012 e në vazhdim kreditet penguese për marrjen e moduleve të programit Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" do të jenë si më poshtë:
Studenti që ndjek programin mësimor Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" mund të regjistrohet në lëndët me kode BIO 2... vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 30 ECTS në këtë program studimi.

Neni 8

Kurrikulat e ofruara për studentët.

Kurrikulat e moduleve të ofruara për studentët nga Departamenti i Biologjisë janë paraqitur në syllabyset përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës. Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Biologjisë për programin Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" mund të tërhiqet tek Zyra e Regjistrimit të UV, pas pagesës përkatëse.

Neni 9

Format dhe organizimi i studimit të programit Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit"

Në programin mësimor Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje për provimin final etj). Leksionet, seminarët dhe labororet zhvillohen në ambientet e Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë. Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë: (VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"):

Numri i studentëve në leksion	6 grupe seminare
Numri i studentëve në seminar	35 studentë
Numri i studentëve në laborator	25 studentë
Numri i studentëve në praktika	25 studentë

Neni 10

Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët.

Programi mësimor Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" parashikon në total 15 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore. Për lëndët që përmbajnë module vlerësimi bëhet në bazë të përqindjes së pikëve që studenti ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej moduleve dhe nxihet nota përfundimtare si rezultante e dy vlerësimeve. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCËVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë duke u mbështetur në programin mësimor.

Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet minimalisht me një provim të pjesshëm dhe një provim përfundimtar, plus kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 11

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/ projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/ projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha lëndët. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të Departamentit të Biologjisë.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 12

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FSHT bëhet me një provim paraprak dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. Në qoftë se është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. Në qoftë se studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi AD-HOC për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 13

Rikontrollimi i dijeve të fituara

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet tu nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë.

Edhe studentët që u kanë zgjatur studimet më shumë se dy vjet përtej kohës normale të fitimit të Diplomës Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit", para dhënies së provimit final iu kontrollohen kreditet e fituara.

Neni 14

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Biologjisë. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit e Universitetit. Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë pas përfundimit të semestrit. Orari hartohet nga Departamenti i Biologjisë dhe miratohet nga zëvendës-dekani i FSHT-së dhe zëvendës-rektori akademik i UV. Orari duhet të jetë i detajuar me sallat përkatëse dhe mund të ndryshojë vetëm me miratimin e zëvendës-rektorit akademik ose rektorit të UV.

Neni 15

Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin.

Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 80%.

Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.

Frekuentimi i laboratorëve është i detyrueshëm në masën 100%. Nëse, për arsye objektive, do të ketë mungesa në orë të veçanta laboratorike, do të gjendet koha e përshtatshme për zëvendësimin e tyre.

Neni 16





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Karakteristikat e Detyrave/ Projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit në programin Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit" do të jenë dy tipesh: (individuale apo në grup).

**Neni 17
Provimi Përfundimtar**

Në fund të programit të studimit, në kurrikul është parashikuar një Provim Përfundimtar i cili konsiston në një kontroll final të njohurive të përfituara nga studenti gjatë periudhës 2-vjeçare të studimeve në programin e Diplomës Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit". Para zhvillimit të provimit final, studenti do të marrë një program orientues në lidhje me lëndët dhe kapitujt që do të testohen në këtë provim.

**Neni 18
Modalitetet për dhënien e diplomës në programin Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit"**

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të studimeve në programin Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit", në Fakultetin e Shkencave Teknike – UV janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disipinat: e formimit të përgjithshëm karakterizuese ndërdisiplinore, të lidhura me disipinat karakterizuese, disipinave me zgjedhje dhe për njohuri të tjera formuese (gjuhë e huaj) etj.
2. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në Provimin Përfundimtar, sipas kërkesave të paraqitura në Nenin 17 të Rregullores së këtij programi mësimor.
3. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar 120 ECTS (kredite).

Procedura e diplomimit

1. Studenti paraqet në Sekretarinë e Departamentit të Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Teknike kërkesën për diplomim, së bashku me gjeneralitetet personale.
2. Në bazë të kërkesës së studentit merret një kopje e listës së notave të studentit nga Zyra e Rregjistrimit të "Universitetit Ismail Qemali"-Vlorë.
3. Komisioni i verifikimit të diplomave verifikon plotësimin e kriterëve të diplomimit për **Diplomë Profesionale në "Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit"**.
4. Nëse pas verifikimit konstatohet se studenti i ka plotësuar kriteret për tu diplomuar, Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Teknike paraqet në Rektorat aprovimin e diplomimit të studentit në fjalë.
5. Pasi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali"-Vlorë aprovon kërkesën për diplomim Zyra e Rregjistrimit plotëson Diplomën dhe suplementin e Diplomës për çdo student.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

6. Studenti merr formularin për marrjen e diplomës tek Zyra e Rregjistrimit dhe paraqitet në Bankë për të bërë pagesën.
7. Pasi bën pagesën, me faturën e bankës tërheq Diplomën tek Zyra e Rregjistrimit.
8. Nëse studentit i nevojitet program, merr formularin për program tek Zyra e Rregjistrimit, bën pagesën tek Banka, më pas tërheq programin e firmosur nga Zv.Rektori dhe të vulosur tek Zyra e Rregjistrimit.

Neni 19
Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të FSHT konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës.

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Shkencave Teknike.

Vendimin për përjashtimin nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasëshme) e merr Rektorati i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 20
Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Shkencave Teknike- UV duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.
2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këta studentë të pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrazimeve (të cilat e përpunojnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifraximet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

3. Mashtrim në raporte laboratorit duke fallsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.

4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike, duke përfshirë modifikimin e skedarëve kompjuterike, të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë, përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 21

Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko-ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal, këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhë, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektorati.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

Neni 22

Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Fakultetin e Shkencave Teknike përcaktohen në rregulloren e Universitetit 'Ismail Qemali' të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara, para fillimit të semestrit.

Neni 23

Dispozita të veçanta

Departamenti i Biologjisë dhe Dekanati i FSHT-së ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

Përgjegjëse e Departamentit
Aurora Bakaj
(Signature)

